

L I G J
Nr.7871, datë 9.11.1994

PËR LOJËRAT E FATIT DHE KAZINOTË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
LOJA E FATIT

Neni 1
Lojërat e fatit

Lojëra fati janë lojërat ku fitimi ose humbja e pjesëmarrësve në to është e varur pjesërisht ose tërësisht nga rastësia.

Nuk quhen lojëra fati:

- konkurset e ndryshme që zhvillohen mbi njohuritë, fituesi i të cilave merr çmimin e caktuar për këtë qëllim;
- pagesat e rrjedhura nga sigurimi i jetës ose llojeve të tjera të sigurimit, që bëhen me anë të tërheqjes me llotari.

Neni 2

Të drejtën për dhënien e lejes për zhvillimin e lojërave të fatit e ka Ministria e Financave, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Neni 3
Loto

Lotoja është një lojë fati, për zhvillimin e së cilës organizatori i saj ofron si shans për të fituar gjetjen e disa numrave nga një tërësi numrash. Nxjerja e numrave fitues bëhet e hapur për publikun. Shuma që u takon fituesve të kësaj loje ndahet sipas kategorive të fituesve. Fituesit e së njëjtës kategori marrin të njëjtën shumë.

Neni 4
Konkursi i parashikimeve sportive

Konkursi i parashikimeve sportive është një lojë fati, gjatë zhvillimit të së cilës organizatori ofron si shans për të fituar gjetjen e rezultateve të ndeshjeve ose garave sportive. Shpallja e rezultateve të ndeshjeve ose garave sportive bëhet publike. Shuma që u takon fituesve të kësaj loje ndahet sipas kategorive të fituesve. Fituesit e së njëjtës kategori marrin të njëjtën shumë.

Neni 5
Llotaria e numrave

Llotaria e numrave është ajo lojë fati, gjatë zhvillimit të së cilës organizatori ofron si shans për të fituar gjetjen e numrit të shënuar në biletë. Tërheqja e shortit për biletat fituese bëhet e hapur për publikun. Shuma që u takon fituesve ndahet sipas kategorive të biletave fituese.

Llotaria e numrave mund të bëhet edhe si lojë shoqëruese me lojërat e fatit të parashikuara në

nenet 3 dhe 4 të këtij ligji.

Neni 6 **Llotaria e çastit**

Llotaria e çastit është ajo lojë fati, gjatë zhvillimit të së cilës organizatori ofron si shans për të fituar çmimin fitues të shënuar në mënyrë të fshehur në biletë. Çmimi që i takon fituesit i jepet menjëherë me gjetjen e simboleve ose të shumës së fshehur në biletë.

Neni 7 **Lojërat e fatit automatike**

Lojë fati automatike është loja që realizohet me një makinë me anën e së cilës fitimi ose humbja dhe dorëzimi i shumës fituese bëhet automatikisht nga vetë makina.

Neni 8 **Leja dhe organizatori**

1. Të gjithë lojërat e fatit të parashikuara në nenet 3, 4,5 dhe 6 të këtij ligji, zhvillohen në bazë të lejes së dhënë organizatorit nga Ministria e Financave.

Të drejtën e marrjes së lejes për zhvillimin e lojërave të fatit e kanë organizatorët që plotësojnë këto kushte:

- a) të ketë si veprimtari të vetme zhvillimin e lojërave të fatit;
 - b) organizatori të jetë person fizik ose juridik rezident në Republikën e Shqipërisë me një kapital themeltar mbi 500 000 lekë;
 - c) të ketë personel me kualifikim të përshtatshëm dhe përvojën e nevojshme për të zhvilluar lojërat e fatit;
 - ç) të garantojë në çdo moment pagesat e fituesve të lojërave të fatit, duke vendosur për këtë qëllim një fond garancie në një nga bankat me seli në Republikën e Shqipërisë, në masën e shumës që u takon fituesve, sipas përcaktimit që bën Ministria e Financave.
2. Leja i jepet organizatorit për një afat deri në 10 vjet, por me kusht që ajo të përsëritet çdo vit.

Neni 9 **E drejta e zhvillimit të lojërave të fatit**

Të drejtën e marrjes së lejes për zhvillimin e lojërave të fatit automatike të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, e kanë personat fizikë dhe juridikë, që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Ministria e Financave. Taksa për çdo automat caktohet 12 mijë lekë në muaj. Leja i jepet organizatorit nga organet tatimore në rrethe për një afat deri në 10 vjet, por me kusht që ajo të përsëritet çdo vit.

Neni 10 **Detyrimet e organizatorit**

Organizatori gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij duhet të plotësojë këto kushte:

- a) të shlyejë rregullisht dhe brenda afateve detyrimet ndaj shtetit dhe të tretëve;
- b) të marrë miratimin paraprak të Ministrisë së Financave për hapjen e filialeve të shoqërisë së tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) të pranojë autoritetin e Ministrisë së Financave në caktimin në organet drejtuese të shoqërisë e në komisionin e lojës së fatit të një mbikëqyrësi të Ministrisë së Financave.

Neni 11 **Kushtet dhe rregullat e zhvillimit të lojërave të fatit**

1. Organizatori duhet të bëjë të njohura publikisht kushtet dhe rregullat për zhvillimin e lojës së fatit, të cilat duhet të jenë të miratuara paraprakisht nga Ministria e Financave. Publikimi i kushteve

dhe rregullave të lojës bëhet nga organizatori pa pagesë me anë të mjeteve të informacionit, në pikat e shitjes dhe të grumbullimit të biletave të lojërave të fatit, me qëllim që t'u jepen personave të interesuar ose lojtarëve.

2. Në lojën e lotove, llotarive, konkurseve të parashikimeve sportive dhe llotarive të çastit duhet të jenë parashikuar:

- shuma ose përqindja që u takon fituesve;
- ndarja e kategorive të fituesve;
- shuma ose përqindja e kostos së administrimit të lojës së fatit;
- rregullat për tërheqjen e numrave fitues;
- mënyra e tërheqjes;
- për konkurset parashikuese sportive, ndeshjet ose garat sportive për të cilat do të luhet;
- vlefshmëria e biletave fituese dhe tërheqja e shumës fituese.

Neni 12

Ndarja e të ardhurave nga lojërat e fatit

1. Të ardhurat e grumbulluara nga lojërat e fatit do të ndahen nga organizatori në përputhje me mënyrën e përcaktuar në lejen e dhënë nga Ministria e Financave.

2. Fitimi i realizuar nga organizatori, pas ndarjes së të ardhurave, është një fitim i tatueshëm.

KREU II KAZINOTË

Neni 13

Leja për hapjen e kazinove jepet nga Këshilli i Ministrave me propozim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 14

Organizatori i kazinove

Leja për zhvillimin e veprimtarisë së kazinove i jepet asaj shoqërie, e cila plotëson kushtet e mëposhtme:

- të jetë shoqëri anonime, rezidente në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- të ketë si të vetmen veprimtari të saj atë të kazinove;
- të ketë persona që marrin pjesë në organet drejtuese, me njohuri profesionale në fushën e kazinove;
- të ketë një kapital themeltar jo më pak se 30 000 000 lekë;
- të garantojë në çdo kohë pagimin e fituesve në lojërat e ndryshme në kazino.

Neni 15

Këshilli i Ministrave përcakton vendin e hapjes së kazinove dhe numrin e tyre. Ai jep leje për të zhvilluar veprimtarinë e kazinove në përputhje me një

politikë të caktuar për një afat prej 10 vjetësh, duke rezervuar të drejtën e tij për t'i anuluar këto leje, kur shkelen kushtet e lejes.

Neni 16

Çdo organizator që do të marrë lejen për veprimtari kazinoje, duhet të paguajë një taksë në masën prej 20 000 000 lekë e cila paguhet vetëm një herë me marrjen e lejes.

Neni 17

1. Organizatori nuk mund të hapë filiale të tij si brenda dhe jashtë vendit, pa marrë miratimin

nga Këshilli i Ministrave.

2. Organet drejtuese të organizatorit do të emërohen vetëm pasi të jetë marrë më parë miratimi i Ministrisë së Financave. Në organet drejtuese të organizatorit do të jetë detyrues një përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe një i Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 18

Rregullat e lojërave

Organizatori duhet që për çdo lojë që do të luhet në kazino, të bëjë të njohur publikisht rregullat e saj, në mënyrë që pjesëmarrësit në lojë të njihen me to.

Në rregullat e lojërave, veç të tjerave, duhet të jenë:

- rregullat për mënyrën e pjesëmarrjes në lojë dhe përcaktimi i shumave minimale dhe maksimale që mund të vihen për çdo lojë;

- kushtet për hyrjen e personave në kazino (vërtetimi i identitetit, kontrolli i pjesëmarrjes);

- oraret e hapjes dhe të mbylljes së kazinos, si dhe çmimin e hyrjes.

Miratimi i rregullave të lojërave në kazino bëhet nga Ministria e Financave.

Neni 19

Të punësuarit në kazino

Në kazino lejohet të punësohen persona të moshës 21 vjeç e lart, të cilët duhet të mos jenë dënuar për vepra penale sipas përcaktimit që bën Ministria e Drejtësisë.

Organizatori, në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik, duhet të përcaktojë mënyrën e ruajtjes së kazinos dhe të kontrollit të personave që futen në të.

Neni 20

Ndarja e të ardhurave

Të ardhurat vjetore që realizohen në kazino, shpërndahen nga organizatori në përputhje me lejen e dhënë nga Këshilli i Ministrave. Pjesa e mbetur e të ardhurave, pas zbritjes së shpenzimeve, do t'i nënshtrohet ligjit "Për tatimin mbi fitimin".

KREU III

MBIKËQYRJA E LOJËRAVE TË FATIT DHE KAZINOVE BILETA DHE SANKSIONET

Neni 21

Organizimi i mbikëqyrjes

Për mbikëqyrjen e lojërave të fatit dhe kazinove, pranë Ministrisë së Financave krijohet Komiteti i Lojërave të Fatit dhe Kazinove. Funksionet, përbërja dhe kompetencat e këtij Komiteti caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 22

Bileta e lojërave të fatit

Pjesëmarrja e shtetasve në lojërat e fatit bëhet kundrejt pagesës për blerjen e biletës së lojës së fatit, e cila është letër me vlerë, ose që bëhet e tillë gjatë zhvillimit të lojës së fatit.

Neni 23

Sanksionet

1. Shkelja e rregullave të caktuara në këtë ligj nga organizatorët e tyre për lojërat e fatit, kur nuk formon vepër penale dënohet për kundërvatje administrative nga inspektorët e tatimeve me gjobë 500 000 lekë.

2. Shkelja e rregullave nga organizatorët të caktuara në këtë ligj për kazinotë, kur nuk formon vepër penale, dënohet për kundërvajtje administrative nga inspektorët e tatimeve me gjobë 10 000 000 lekë.

3. Heqja e lejes bëhet nga organi që jep lejen kur konstaton shkelje të rënda të këtij ligji.

4. Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim ose protestë brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja. Vendimi gjyqësor është i formës së prerë.

5. Konstatimi e shqyrtimi i kundërvajtjeve dhe ekzekutimi i vendimeve të dënimit bëhen sipas ligjit “Për kundërvajtjet administrative”.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministrinë përkatëse të nxjerrin rregulla të hollësishme në zbatim të këtij ligji.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Shpallur me dekretin nr.860, datë 28.11.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.